

PËR PUNËDHËNËSIT QË KANË VENDOSUR TË KONTRAKTOJNË SHËRBIME TË JASHTME TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP)

15 pyetje që t'i bëni vetes para se të nënshkruani
Kontratë me kompani shërbyese për SSHP

Pyetje	Po	Jo	Komente
1. A kam krahasuar disa oferta?			
Ofruesi i shërbimit SSHP			
2. A është e licencuar kjo kompani për shërbime të SSHP?			
3. A ka përvojë ky shërbim i SSHP në fushën e kompanisë sime (p.sh., ndërtim, bujqësi, etj.)?			
4. A mundet ky shërbim i SSHP të ofrojë dëshmi të përvojës (p.sh., kontakte të klientëve të tjerë, letra reference)?			
5. A mundet ky shërbim i SSHP të ofrojë shembuj të dokumenteve të vlerësimit të riskut në vendin e punës, dhe plan të masave parandaluese?			
6. A është e qartë gjithçka që shkruhet në këta shembuj të dokumenteve?			
7. A do të vizitojë kompania e shërbimeve të SSHP të gjitha vendet e punës dhe të vëzhgojë të gjitha proceset e punës në kompaninë time?			
8. A do të përfshijë kompania e shërbimeve të SSHP punëtorët e mi në vlerësim të riskut në vendin e punës?			
9. A mund të kryejë shërbimi i SSHP vetë matje të mjediseve të punës (p.sh., zhurma, dridhjet, ndriçimi, mikroklima, pluhuri, kimikatet etj.) apo do ta nënkontrakttojë atë shërbim?			
10. A ka kompania e shërbimeve të SSHP burime të mjaftueshme kohore?			
11. A mundet shërbimi i SSHP të përfundojë punën në afatin që më duhet?			
12. A jam i kënaqur me mënyrën e komunikimit dhe përgjigjet që marr nga kompania e shërbimeve të SSHP për të gjitha pyetjet e mia në lidhje me SSHP?			
Ekspertët SSHP që punojnë tek ofruesi i kompanisë për shërbime të SSHP			
13. A kanë certifikatë valide ekspertët e SSHP-së që punojnë me mua?			
14. A kanë përvojë të mjaftueshme (në përgjithësi dhe në fushën e kompanisë sime) ekspertët e SSHP-së që punojnë me mua?			
15. A merret kompania e shërbimeve të SSHP me zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive të ekspertëve të tij (p.sh. trajnimi për ndryshimet e fundit në akte ligjore, këmbimi i praktikave të mira)?			

Nëse merrni të paktën një përgjigje "JO", mendoni nëse keni zgjedhur shërbimin e duhur SSHP!

Për detaje mbi kërkesat ligjore për shërbimet e SSHP, shihni

Rregulloren (MPMS) nr. 01/2021 për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë